



Pranuar / Doretuar Primjena/Pridato Received/Delivered	27.10.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM SHCK	6726	2023	115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1121/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtare, me Flakron Gashi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1123 të datës 29.08.2023 të parashtruar nga ankuesja në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 26.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1123/2023 e datës 29.08.2023 e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 135/2023 i datës 17.08.2023 i Komisionit të Pranimit të Komunës së Vitisë.

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 28.08.2023 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks.gov.net ka parashtruar ankesë pas orarit zyrtar të punës, e cila më pastaj në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil është regjistruar me datë 29.08.2023 nën shenjen A.nr.1123/2023 dhe numër protokoli:5841/2023, kundër me numër 135/2023 i datës 17.08.2023 i Komisionit të Pranimit të Komunës së Vitisë me pretendimin se Komisioni i Pranimit me rastin e vlerësimit të ankueses në fazën e vlerësimit të jetëshkrimit, ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike, ngase në rastet të tjera për konkurse të ngjashme nga institucione tjera është vlerësuar me më shumë pikë si dhe kandidatja fituese ka qenë duke punuar paraprakisht në Komunën e Vitisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 04.09.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Komuna e Vitisë. Ndërsa me datën 07.09.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit, me datë 11.10.2023 Kryetari i Këshillit ka nxjerrë vendimin me shifër VK/2023 dhe numër protokolli:6508/2023 sipas të cilit ankesës së ankueses me shifër A.nr.1123/2023 të datës 29.08.2023 i është shtyrë afati i vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me rastin e shqyrtimit të kësaj lëndë ka administruar këto prova: Ankesën e datës 29.08.2023 të parashtruar nga ankuesja në KPMSHCK; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 04.09.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 07.09.2023; Konkursin e datës 03.05.2023; Listën e ngushtë e datës 05.07.2023; Aplikacionin e ankueses të datës 27.06.2023; Diplomën e datës 04.02.2014 me shifë:No328/13; Diplomën e datës 20.08.2016 me shifë:No828/16; Vërtetimin e lëshuar nga Rikont/2014; Çertifikatë e datës 07.10.2011; Çertifikatë e lëshuar nga MNTF-KFOR 11/2008-2009; Çertifikatë e datës 23.04.2007; Çertifikatë e datës 09.01.2007; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Çertifikatën e datës 27.06.2023 lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës; Kontratë pune e datës 31.07.2012; Vërtetimin e datës 04.07.2015; Kontratë pune e datës 15.07.2020; Vendimin për themelimin e Komisionit të Pranimit i datës 03.03.2022; Akt emërimit e datës 02.11.2011; Akt emërimit e datës 30.12.2011; Akt emërimit e datës 30.12.2011 me shifër 07-112/2389; Akt emërimit e datës 20.04.2016; vendimin e datës 03.02.2023 të Kryetarit të Komunitetit të Vitisë; Formualri i vlerësimit për ankuesen; Formualri i vlerësimit për kandidaten A.M-H; Formualri i vlerësimit për kandidatin B.B; Formualri i vlerësimit për kandidaten A. I-M; Formualri i vlerësimit për kandidatin B.S; Formualri i vlerësimit për kandidatin A.A; Njoftimin e datës 17.08.2023; Njoftimin e datës 09.08.2023; Formularin e renditjes përfundimtare të kandidatëve; Ankesën e ankueses të parashtruar tek Komsioni i Pranimit; Vendimin e Komisionit të Pranimit i datës 17.08.2023; Vendimin e Këshillit A.nr.695/2023; Aplikacionin e datës 22.06.2023 të kandidates A.M-H; Diplomën e datës 04.02.2014 me shifër NO.329/13; Çertifikatën e lëshuar nga BSC Kosovo; Çertifikatën e datës 11.02.2016; Çertifikatën e lëshuar FINCA 15.10.2022; Çertifikatën e datës 12.03.2008; Kopjen e letërnjoftimit të kandidates A.M-H; Çertifikatën e lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës me datë 28.04.2023; pasyren e llogarisë trustit i datës 07.03.2022; Kontratën mbi vepër të datës 16.02.2022; Marrëveshjen për shërbime të veçanta e datës 27.05.2019; Marrëveshjen për shërbime të veçanta e datës 07.03.2018; Marrëveshjen për shërbime të veçanta e datës 20.04.2017; Marrëveshjen për shërbime të veçanta e datës 07.09.2017; vërtetimin e datës 15.03.2017; Vërtetimin për punë praktike; Aplikacionin e datës 20.06.2023 të kandidates A.I-M me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e datës 15.06.2023 të kandidatit B.B me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e datës 23.06.2023 të kandidatit A.A me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e datës 23.06.2023 të kandidatit B.S me dokumentacionin e bashkangjitur; Vendimin e Kryetarit të Këshillit i datës 11.10.2023 me numër prot:6508/2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Komuna e Vitisë me datën 03.05.2023 ka shpallur konkursin e jashtëm për emrin e grupit Specialistë të Përgjithshëm të Tatim-Taksave apo mbledhjes të të Ardhurave me numër të referencës RN00011528 për pozitën "Zyrtar për Evidentimin e Pronës së Paluejtshme-Profesional 3" në kuadër të Drejtorisë për Financa, me kriteret e përcaktuara si në vijim:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë me së paku 3 vite studimeve 180 kredi/ECTS-Fakulteti Juridik, Ekonomik (pavarësisht nga specializimi)*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Nuk kërkohet.*

Kolegji i Këshilli po ashtu ka gjetur se Komisioni i Pranimit të Komunës së Vitisë pash zhvillimit të gjitha fazave të vlerësimit sikurse parashihet me nenin nenin 16 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është e përcaktuar se: "1. Vlerësimi i kandidatëve kryhet nga Komisioni i Pranimit i themeluar në pajtim me nenin 17 dhe/ose përkatësisht nenin 18 të kësaj Rregulloreje. 2. Vlerësimi i kandidatëve, përfshin, sipas radhës: 2.1. vlerësimin nëpërmjet një testimi me shkrim; 2.2. vlerësimin e jetëshkrimit /CV, dhe 2.3. vlerësimin nëpërmjet një interviste me gojë", ka hartuar Formularin e Renditjes Përfundimtare të Kandidatëve, sipas të cilit ankuesja është renditur e nënta (9) me radhë pasi që ka arritur të grumbulloi gjithësejt gjashtëdhjetë e gjashtë (66) pikë apo për secilën fazë veç e veç (52 pikë në testin me shkrim, 10 pikë në jetëshkrim dhe 4 pikë në intervistën me gojë), ashtu që e njëjta nuk ka mundur ta kalojë pragun minimal prej shtatëdhjetë (70) pikëve të cilat janë të nevojshme për të qenë kandidat fituese sikurse përcaktohet me paragrafin 2 neni 25 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës: "Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues. Njësia Përgjegjëse publikon listën e kandidatëve fitues në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje".

Me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimit ankimor të ankueses Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 22 paragrafi 4 ku përcaktohet se: "Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri në njëzet (20) pikë, të ndara, si vijon: 4.1. deri në tetë (8) pikë për cilësinë dhe nivelin të arsimit; 4.2. deri në shtatë (7) pikë për përvojën domethënëse në punë; dhe 4.3. deri në pesë (5) pikë për trajnimet." Dhe ka ardhur në përfundimin se Komisioni i pranimit ka zbatuar dispozitat e rregullores në fjalë ashtu që të gjithë kandidatët të cilët e kanë plotësuar kriterin formal të kualifikimit arsimor që të gjithë i ka vlerësuar me nga 8 pikë, asnjërit prej kandidatëve nuk i kanë vënë pikë tek përvoja e punës pavarësisht faktet që kanë pas përvojë ngase tek kjo pozitë nuk kërkohet përvoja e punës, sikurse edhe poentimi e trajnimeve e kanë bërë sipas udhëzimit se trajnimet që lidhen me vendin e punës në lëminë përkatëse lidhur me Grupin e Pozitës për të cilët zhvillohet konkurrimi marrin më shumë pikë, nga rrjedh se kandidatja më e suksesshëm e cila ka arritur të grumbulloi gjithësej 74.6, e cila realisht është kandidatja potenciale për emërim, sipas vlerësimit nga Komisioni i Pranimit për fushën e trajnimeve ka marr pesë (5) pikë, ngase e njëjta ka poseduar certifikatën mbi aftësimin profesional të datës 11.02.2016 të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale sipas së cilës dëshmohet fakti se e njëjta ka ndjekur trajnimin në Kontabilitet për modulet: Hyrje në kontabilitet, mbajtja e evidencës së arkës, llogaritja e pagave, mbajtja e

evidencës së shitjeve dhe blerjeve, mbajtja e evidencës së mjeteve themelore, mbajtja e evidencës së detyrimeve, mbajtja e evidencës mbajtja e evidencës së depos dhe përgatitja e pasqyrave financiare e që në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit me rastin e vlerësimit me pikë maksimale lidhur me fushën e trajnimeve, Komisioni i Pranimi ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 22 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni ku përcaktohet se: “Vlerësimi i jetëshkrimit konsiston në vlerësimin e cilësisë dhe nivelit të arsimimit, të përvojës domethënëse në punë dhe të trajnimeve që lidhen me vendin e punës në lëminë përkatëse të lidhur me Grupin për të cilët zhvillohet konkurrimi” ndërlidhur me nenin 22 paragrafi 4 nën paragrafi 4.3 të së njëjtës rregullore, ngase trajnimi i ankueses është në lëminë përkatëse që lidhet me grupin e pozitës së shpallur Specialistë të Përgjithshëm të Tatim-Taksave apo mbledhjes të të Ardhurave sipas konkursit të datës 03.05.2023, kurse ankuesja në dosjen e saj ka poseduar certifikata që kryesisht kanë të bëjnë me përfundimin e kurseve të gjuhëve të huaja-angleze dhe kursit të kompjuterëve, nga rrjedh se e ankuesja nuk ka mundur të vlerësohet me pikë maksimale për arsyet e dhëna si më lartë në dispozitat e lartcekura të rregullores.

Kolegji i Këshillit, nga se u tha dhe konstatua si më lartë, sjellë në vëmendje se sa i përket pretendimit ankimor të ankueses se e njëtat në konkurse të ngjashme të zhvilluara nga institucione të tjera e nejta është vlerësuar më shumë pikë në fazën e jetëshkrimit, nuk mundet të shqyrtohet si pretendim në parim ngase konkuret e tjera ku ankuesja ka qenë aplikante nuk janë objekt i shqyrtimit në këtë këtë procedurë administrative të hapur sipas ankesës së parashtruar në Këshill me datë 29.08.2023, Kolegji i Këshillit nuk mund të vlerësojë një procedurë të rekeurtimit përmes funksionit të shqyrtimit të ankesve përderisa për procedurën në fjalë së cilës i referohet për analogji ankuesja nuk është parashtruar ankesë nga njëta, kësaj përderisa nuk ka një akt administrativ nga një organë mbikqyrës që konfirmon ligjshëmrinë e asaj procedura, vlerësimet të cilat iu referohet ankuesja nuk mund të mirren për bazë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se Zyra e Personelit në Komunën e Vitisë, me rastin e publikimit të rezultateve përfundimtare sipas Njoftimit të datës 17.08.2023 lidhur me renditjen përfundimtare për rezultatet e vlerësimit për grupin e pozitave Specialistë të Përgjithshëm të Tatim-Taksave apo mbledhjes të të Ardhurave me numër të referencës RN00011528 për pozitën “Zyrtar për Evidentimin e Pronës së Paluejtshme-Profesional 3” në Drejtorinë e Financave si dhe nxjerrja Vendimit me numër 135/2023 i datës 17.08.2023 nga Komisionit i Pranimi të Komunës së Vitisë, kanë vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe nenin 25 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1121/2023

Flakron GASHI


Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.